



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. D.P.T "Tini", Adresa: Krushë e Madhe, p.n. Rahovec R. e Kosovës, me NRB. 810734906

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe D.P.T "Tini". - Krushë e Madhe, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. D.P.T "Tini"- Krushë e Madhe do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin BIZNESI, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikën e këtij institucionit.
2. Kolegji BIZNESI do të mbështesë në vazhdimësi D.P.T "Tini".- Krushë e Madhe në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.

3. Kolegji BIZNESI do të mbështes, D.P.T "Tini"- Krushë e Madhe me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomis dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet D.P.T "Tini"- Krushë e Madhe.

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


Neni 6

Hyrja në fuqi


Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë


/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/
D e k a n

D.P.T "Tini"


/Arjeta Imeri/
Drejtore



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 11/12/2020